

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITR
02 Nr./Br. 274/20
Nr. i fq./Br. sf
Data: / Datum 10.03.2020
VUSHTRRI - VUČITR



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës numër 20-SHV01-002-60 datë 25.02.2020, në shumë prej 84.00 € (tetëdhjetë e katër euro), me rastin e shpenzimeve të krijuara nga Nënkryetari i Komunës në “Amazona Hotel” SH.p.k, në Milloshevë, Obiliq (ushqim dhe pije freskuese) me përfaqësues të KFOR-it.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITEN

02 Nr./Dr. 275/20

Nr. i fig./Dr. st.

Data: / Datum 10.03.2020

VUSHTRRI - VUČITEN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës numër 20-SHV58-001-7356 datë 07.03.2020, në shumë prej 804.00 € (tetëqind e katër euro), me rastin e shpenzimeve të krijuara në SH.P.K, “Liqeni i Dukagjinit” në Gjakovë (ushqim dhe pije freskuese) me gratë e punësuar në administratën e komunës, me rastin e shënimit të “8 marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas”.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Administratë – Njësia për barazi gjinore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRAN
02 Nr. / Br. 285/20
Nr. i Sq. / Br. st.
Data: / Datum 12.03.2020
VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenit 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe me propozim të Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni i përbashkët me përfaqësues nga: Komuna e Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë, për shqyrtim të aplikacioneve në projektin “Mbështetje e qëndrueshme e jetesës për familjet me jetimë dhe në nevojë, përmes fermave të vogla bujqësore dhe me bagëti”, në Komunën e Vushtrrisë.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
 - 1.1 **Ragbete Krasniqi** - kryesuese e komisionit, Komuna Vushtri
 - 1.2 **Avdyl Feka** - anëtar, Komuna Vushtri
 - 1.3 **Kimete Mehana** - anëtar, Komuna Vushtri
 - 1.4 **Blerim Gashi**, - anëtar, Islamic Relief
 - 1.5 **Kosovare Pajaziti**, anëtare, Islamic Relief
3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj, vlerësoj dhe përzgjedhë përfituesit më meritore të këtij projekti duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen publike për këtë projekt datë 26.02.2020. Komisioni për punën e tij do të i raportoj Kryetarit të Komunës.
4. Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e realizimit të këtij projekti.
5. Komuna dhe Islamic Relief, brenda afatit të caktuar ligjorë do të lidhin kontratë me përfituesit e këtij projekti.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për EBPZHR
- Islamic Relief në Kosovë
- Anëtarëve të Komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITR	
02 Nr. / Br	289/20
Nr. i Sq. / Br. st	
Data: / Datum	12.03.2020
VUSHTRRI - VUČITR	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 01/07 lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Kosovë dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave parandaluese në Komunën e Vushtrisë, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Komuna e Vushtrisë u bënë thirrje qytetarëve që sa më shumë që është e mundur të zvogëlojnë frekuentimin në zyrat komunale.
2. Inkurajohen qytetarët e komunës së Vushtrisë që në komunikim të drejtpërdrejt me komunën të shfrytëzojnë linjën telefonike në Qendrën e thirrjeve të Komunës në numrin e tel. pa pagesë **0800 42000** për shërbimet që ata duan të marrin nga komuna. Aty do ti marrin informatat e hollësishme për shërbimet që mund ti kryejnë.
3. Shërbimi në qendrën e thirrjeve është në dispozicion për qytetarë çdo ditë të javës, nga e hëna deri të premten, prej orës 08:00 deri 16:00.
4. Komuna pezullon shërbimin me palë në drejtoritë tjera me përjashtim të rasteve emergjente.
5. Të gjitha shërbimet e gjendjes civile dhe shërbimet tjera do të kryhen në sportelet në Qendrën e Shërbimit të Qytetarëve katin përdhes të Komunës.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
7. Zyra për informim e komunës do të bëj publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të komunës. Gjithashtu të publikohen edhe numrat tjerë telefonik të drejtorive dhe zyrave përmes të cilëve qytetarët do të mund të drejtohen me pyetjet dhe kërkesat e tyre.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITAN
02 Nr./Br. 290/20
Nr. i lq./Dr. sh. -02-
Data:/Datum 12.03.2020
VUSHTRRI - VUČITAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 12 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB-Nr. 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 01/07, me rekomandim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në mbledhjen e mbajtur me datë 12.03.2020 lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Komunën e Vushtrrisë, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërmarrjen e masave preventive për mbrojtje nga korona virusi si në vijim:


1. Të formohet Shtabi Komunal ndër sektorial për koordinim të aktiviteteve preventive për parandalim të COVID 19. Drejtori i Shëndetësisë do të jetë në krye të këtij Shtabi. Pjesë e Shtabit janë: Policia e Kosovës, Drejtoria e Emergjencave, Shërbimeve Publike, Inspektorati Komunal, Arsimi, Përfaqësues i Bizneseve, Përfaqësues i BIK, OJQ, përfaqësues i Spitalit "Sheik Zayed",
2. I gjithë stafi i Kujdesit Primar Shëndetësor si dhe institucionet e kujdesit primar shëndetësor të jenë në gjendje gatishmërie, të ndërpriten pushimet e stafit si dhe të krijohet lista e personelit mjekësor jashtë QKMF-së në rast nevojë,
3. Të dezinfektohen të gjitha institucionet publike komunale menjëherë,
4. Të bëhet dezinfektimi i të gjitha lokaleve e bizneseve në Komunë (me urgjencë Qebaporet, çajtoret, restorantet dhe kafiteritë). Inspektorati i Komunës do të inspektojë të gjitha bizneset dhe do të marrë masa adekuate ligjore kundër secilit që shmang dezinfektimin e lokalit,
5. Kërkojmë nga bizneset që të mos bëjnë ngritjen e çmimeve duke shfrytëzuar situatën e krijuar me koronavirusin. Inspektorati komunal do të monitorojë dhe do të reagojë me masa ligjore ndaj subjekteve afariste që manipulojnë me çmime të produkteve,
6. Institucionet fetare do të kryejnë shërbimet fetare me kohë të reduktuar; të bëhet dezinfektimi i objekteve fetare po ashtu,

7. Komuna e Vushtrrisë inkurajon qytetarët që në komunikim të drejtpërdrejt me komunën të shfrytëzojnë linjën telefonike në Qendrën e thirrjeve të Komunës së Vushtrrisë në numrin pa pagesë 0800 42000 për shërbimet që ata duan të marrin nga komuna,
8. Aty do ti marrin informatat e hollësishme për shërbimet që mund ti kryejnë,
9. Shërbimi në qendrën e thirrjeve është në dispozicion për qytetarë çdo ditë të javës, nga e hëna deri të premten, prej orës 08:00 deri 16:00,
10. Komuna pezullon shërbimin me palë në drejtoritë tjera me përjashtim të rasteve emergjente,
11. Të gjitha shërbimet e gjendjes civile dhe shërbimet tjera do të kryhen në sportelet në Qendrën e Shërbimit të Qytetarëve katin përdhes të Komunës ndërsa të punësuarit do të pajisen me mjete mbrojtëse,
12. Shërbimi i Zjarrfikësve të jetë në gjendje gatishmërie të plotë,
13. Të anulohen konkurset publike për punësim në organet komunale,
14. Urdhërohen bizneset që në hyrje të lokaleve të vendosin dezinfektues,
15. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit,
16. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të komunës.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari


Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 01/07, lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave preventive në Komunën e Vushtrrisë, Kryetari i Komunës, merr këtë:


V E N D I M


PËR FORMIMIN E SHTABIT PËR PARANDALIMIN E COVID-19 NË KOMUNËN E VUSHTRRISE

1. Formohet Shtabi Komunal për koordinim të aktiviteteve preventive për parandalim të COVID 19 Në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 Z. Sylejman Meholli, Drejtor për shëndetësi dhe përkujdesje sociale - kryesues i shtabit
 - 1.2 Afrim Namani, Drejtor për Arsim, - anëtar
 - 1.3 Rrahim Ajeti, Drejtor për inspektime – anëtar
 - 1.4 Bajrush Kosumi, Drejtor për mbrojtje dhe shpëtim, - anëtar
 - 1.5 Refik Maloku, Drejtor për Shërbime Publike, anëtar
 - 1.6 Luljeta Zahiti, Drejtore e QKMF-së, anëtare
 - 1.7 Mursel Pllana, u.d. Drejtor i Spitalit, Vushtrri – anëtar
 - 1.8 Reshat Kovaçi, komandant i stacionit policor në Vushtrri, anëtar
 - 1.9 Haki Novolani, përfaqësues i bizneseve të komunës – anëtar
 - 1.10 Shemsi Rrahimi, Kryetari BI në Vushtrri – anëtar
 - 1.11 Drita Dibrani, Kryetare e KVRL-së – anëtare
2. Detyrë e shtabit është që secili në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiive ligjore të ndërmerr masat e nevojshme për parandalim të shfaqjes përkatësisht përhapjes e Koronavirusit në komunën e Vushtrrisë. Duke ditur se epidemiologjia e koronavirusit tani më është shfaqur në të gjitha vendet fqinje, për shkak të rrezikut të përhapjes së saj edhe te ne, është më se e domosdoshme që të përcillen në çdo kohë kërkesat dhe rekomandimet e Qeverisë së Kosovës dhe Institucioneve më të larta shëndetësore me qëllim që të jemi në nivel të detyrës.
3. Shtabi komunal duhet të jetë i angazhuar 24 orë dhe veproj në bazë të rrethanave dhe situatës së krijuar në terren.

4. Për çdo veprim të ndërmarrë duhet njoftuar organet kompetente sipas ligjit në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe me propozim të shtabit komunal për mbrojtje nga COVID-19 nga mbledhja e mbajtur më 13.03.2020, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

U R D H Ë R E S Ë

1. Me qëllim të ndërmarrjes së masave preventive për mbrojtje nga përhapja e coronavirusit në Komunën e Vushtrrisë urdhëroj që të merren masa dhe aktivitete si në vijim:
 - 1.1 Të bëhet dezinfektimi i të gjitha objekteve publike – shkollave në qytet dhe të gjitha fshatrat, QKMF-së QMF-ve dhe pikave ambulantore në territorin e komunës,
 - 1.2 Të bëhet mbyllja e tregjeve, tregu i shitësve ambulant në qendër të qytetit duke përfshi edhe tregun e bagëtive
 - 1.3 Të punësuarit në administratën e komunës nuk do të vijojnë në punë nëse të dy bashkëshortët janë të punësuar
 - 1.4 Shërbyesit civil që janë me sëmundje kronike lirohen nga ardhja në punë deri në një vendim tjetër
 - 1.5 Të ardhurit në komunën e Vushtrrisë, nga Italia, Gjermania dhe shtetet me përfshirje të lartë nga koronavirusi të vet izolohen për të iu shmangur rrezikut të përhapjes së kësaj sëmundje.
 - 1.6 Secili qytetar i komunës së Vushtrrisë i cili dyshon se mund të jetë i infektuar me koronavirus, të lajmërohen në nr. tel. 038/20080800.
 - 1.7 Edhe përkundër faktit se në Komunën e Vushtrrisë nuk ka asnjë rast të infektimit me koronavirus, të përcillet me vëmendje të shtuar situata e përgjithshme rreth përhapjes së kësaj sëmundje dhe të sillemi me përgjegjësi të plotë në mënyrë që të tejkalohet me sa më pak kjo gjendje në të cilën ndodhemi.
 - 1.8 Drejtoria për inspektimi të merr masa të duhura në terren konform kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara me akte ligjore në fuqi.
2. Shtabi komunal për mbrojtje nga koronavirusi të përcjell me vigjilencë gjendjen në terren dhe ndërmerr masa adekuate në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe duhet të zbatohet menjëherë.


Xhafer Tahiri
Kryetar i komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOS
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITR
01 Nr./Br. 301-2/20
Nr./Tq./D. st.
Data / Datum 15.03.2020
VUSHTRRI - VUČITR



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe me propozim të shtabit komunal për mbrojtje nga COVID-19 pas një diskutimi nga mbledhja e mbajtur më 15.03.2020, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:


Deklaratë Publike

1. Ftojme të ardhurit në komunën e Vushtrrisë, nga Italia, Gjermania dhe shtetet tjera me përfshirje të lartë nga koronavirusi që të vet izoloohen për të iu shmangur rrezikut të përhapjes së kësaj sëmundje.
2. Secili qytetar i komunës së Vushtrrisë i cili dyshon se mund të jetë i infektuar me koronavirus, të lajmërohen në nr. tel. 038/20080800.
3. Edhe përkundër faktit se në Komunën e Vushtrrisë nuk ka asnjë rast të infektimit me koronavirus, të përcillet me vëmendje të shtuar situata e përgjithshme rreth përhapjes së kësaj sëmundje dhe të sillemi me përgjegjësi të plotë në mënyrë që të tejkalohet me sa më pak kjo gjendje në të cilën ndodhemi.
4. Përgëzojmë stafin shëndetësorë të Komunës së Vushtrrisë në për angazhimin e pakursyer në ndërmarrjen e masave preventive dhe për gatishmërinë e tyre për punë të pandërprerë për ruajtje të shëndetit dhe jetës së qytetarëve.
5. Si komunë do të përcjellim me vëmendje të shtuar gjendjen në terren dhe do të ndërmerren masa adekuate në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrrisë

Kryetari i Komunës

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/07 të datës 11.03.2020, Kryetari i Komunës, nxjerr:

U R D H Ë R E S Ë

1. Me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve të komunës sonë nga infektimi me Korona Virus - COVID19, reduktohet numri i shërbimeve komunale në administratën komunale në Vushtrri .

2. Në çdo drejtori, do të organizohet puna në atë mënyrë që çdo ditë do të angazhohet vetëm nga një shërbyes civil, i cili do të kujdestaroj vetëm për ofrimin e shërbimeve të domosdoshme .

3. Çdo Drejtor i Drejtorisë, përkatësisht çdo udhëheqës i zyrës do ta caktoj shërbyesin civil- kujdestar dhe do ta njoftojë zyrën e kryetarit dhe udhëheqësin e personelit për nëpunësin kujdestar.


4. Urdhëresa hynë në fuqi menjëherë dhe vlen deri në një njoftim tjetër.

5. Për zbatimin e urdhëresës do të perkujdesen nën kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësi i personelit



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe me rekomandim të shtabit komunal për mbrojtje nga COVID-19, nga mbledhja e mbajtur më 19.03.2020, Kryetari i Komunës me datën 20.03.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Nga buxheti i Drejtorisë për Shërbime Publike, kategoria mallra dhe shërbime, lejohen mjete financiare në shumë prej 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro) pako sociale (gjëra ushqimore dhe të higjienës për familje në gjendje të rëndë sociale. Vlera e pakos 45.00 € për familje.
2. Obligohet drejtoria për Shërbime Publike që të bëjë listimin e artikujve ushqimorë dhe higjienik deri në vlerën totale të përcaktuar në pikën paraprake të këtij vendimi.
3. Nga buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale lejohet poashtu blerja e dymijë e njëqind (2100) maskave në vlerë deri në dymijë euro (2,000.00 €) për mbrojtje nga koronavirusi për nevoja të shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë.
4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje sociale ngarkohet që në bashkëpunim me QKMF-në të kujdeset për distribuimin e maskave mbrojtëse për punëtorët shëndetësorë të komunës si dhe për stafin e administratës së komunës të cilët janë të angazhuar në punët e përditshme në komunë.
5. Obligohen drejtoritë nga pika 2 dhe 3 e këtij vendimi që të iniciojnë procedurën për zotim të mjeteve financiare dhe procedojnë në Drejtorinë për Prokurim Publik për zbatim të procedurave të mëtejme të prokurimit konform rregullave të prokurimit dhe konform vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpalljen e gjendjes emergjente të shëndetit publik datë 15.03.2020.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Shërbime Publike
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Prokurim Publik
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, nenin 67 shkronja "f" dhe "g" të Statutit të Komunës dhe rekomandimet e shtabit komunal për mbrojtjen nga COVID-19 nga mbledhja e mbajtur më 23.03.2020, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT


1. Formohet komisioni për shpërndarje të ndihmave me pako sociale (artikuj ushqimor dhe higjienik) për familjet në gjendje të rëndë sociale në Komunën e Vushtrrisë, të cilat nuk janë në gjendje të i përmbushin nevojat tyre elementare, nga situata e krijuar me përhapjen e koronavirusit dhe rrezikut të infektimit me këtë virus.
2. Përbërja e komisionit:
 - 2.1 Kimete Mehana, kryesuese e komisionit
 - 2.2 Naim Ferizi, anëtar
 - 2.3 Isak Uka, anëtar
 - 2.4 Fatmir Musliu, anëtar
 - 2.5 Drita Dibrani, anëtare
3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë shpërndarjen e ndihmave që do të sigurohen nga buxheti i komunës - pako sociale (artikuj ushqimorë dhe higjienik) për familjet në Komunën e Vushtrrisë, të cilët janë në gjendje të rëndë sociale, për të lehtësuar sado pak gjendjen materiale të kësaj kategorie të qytetarëve.
4. Ky komision gjithashtu do të merret me shpërndarjen edhe të ndihmave tjera materiale për këto kategori në rast se do të sillen nga donatorë të ndryshëm në Komunën e Vushtrrisë.

5. Shpërndarja e pakove sociale nga pika 3 dhe 4 e këtij vendimi duhet të bëhet në mënyrë të organizuar duke i dërguar secilës familje në shtëpitë e tyre, për të evituar mundësinë e grumbullimeve të qytetarëve dhe rrezikun e përhapjes së infektimit të tyre.
6. Mandati i komisionit do të zgjas për aq kohë sa do të zgjas gjendja e ballafaqimit me këtë pandemi respektivisht nevojës për shpërndarje të këtyre ndihmave.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
- Qendrës për Punën Sociale
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, nenin 67 shkronja "g" të Statutit të Komunës dhe rekomandimet e shtabit komunal për mbrojtjen nga COVID-19, nga mbledhja e mbajtur më 23.03.2020, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

U R D H Ë R E S Ë

1. Urdhërohen pronarët e furrave të bukës në Komunën e Vushtrrisë, që të sigurojnë ambalazhimin e bukës në dyqanet e tyre, për të evituar mundësinë e infektimit dhe përhapjes së virusit pandemik COVID-19.
2. Me rastin e furnizimit të klientëve me bukë përkatësisht produktet nga mielli, të bëhet shenjëzimi i rreshtimit të qytetarëve në pritje, në distancë prej dy metrash dhe të kujdesen për respektim të kësaj distance.
3. Pronarëve të mullinjëve në Komunën e Vushtrrisë, iu rekomandohet që të iu ipet prioritet furnizimit me miell të furrtarëve të furrave në territorin e komunës, në mënyrë që të sigurohet furnizim i rregullt me bukë i qytetarëve.
4. Pronarët e dyqaneve (bizneseve) private të cilat janë të lejuara të punojnë me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të bëjnë shenjëzimin për pritje në radhë, në distancë prej dy metrash, për shmangie të mundësisë së infektimit të qytetarëve të cilëve iu ofrohet shërbimi.
5. Për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj urdhërese obligohet Drejtoria për Inspektime e cila do të raportoj te Kryetari i Komunës gjegjësisht në shtabin komunal për menaxhim të situatës për mbrojtje nga COVID-19.
6. Urdhëresa hyn në fuqinë ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës